

001



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM (ME NJE OPERATOR)

KOMUNA E ISTOGUT, Njësia e Prokurimit të cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, në cilësinë e porositësit të shërbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

NT "CHARLY" me pronar NEZIR ZEQRAR, Rr. "VËLLEZERIT ZEQRAR" Nr. 15 me Nr. Regjistrimit të biznesit: 70695812 në vazhdim "Furnizuesi", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet si me poshtë:

FURNIZIMI I INSTITUCIONEVE KOMUNALE ME LËNDË DJEGËSE - DRU

Nr. I prokurimit	633-18-107-1-2-1/FA 021
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 001/ 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

1.2 FURNIZIMI I INSTITUCIONEVE KOMUNALE ME LËNDË DJEGËSE - DRU

~~Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit~~

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me NENSHKRIMIN E SAJË PERKATESISHT ME DATË 05.03.2018 DHE DO TE PËRFUNDOJË ME SE LARTI DERI ME 05.03. 2019 PASI KONTRAKTORI TE DESHMOJE SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFISHMERI PREJ 13 MUAJVE, NGA DATA E NENSHKRIMIT TE KONTRATËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha FURNIZIMEVE do të jetë: 05.03.2019.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë KOMUNA E ISTOGUT – INSTITUCIONET ARSIMORE, SHENDETËSORE DHE KOMUNALE.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi I dates: 09.02.2018

Vlera totale indikative e kontratës është: 105.000,00 Euro.

Dhe me shkronja: /Njëçindpeseeuro/

4.2 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vleres se kontrates) po qe se per këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Po qe se urdherblerjet kalojnë sasinë totale te kontrates publike kornizë (duke perfshirë + 30%), pa marre parasysh daten origjinale te nenshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

4.3 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër dhe limiti i përmendur në nenin 4.2, duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.4 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani për menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj",

"vërtetues", "miratues" ose "vendosës" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]2 in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktuesin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Nezir Zeqiraj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.03.2018	Data:	07.03.2018
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës, në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Tshnim ato jo relevante.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	8.1	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS ËSHTË 10 % E VLERES SE PARASHIKUAR TE KONTRATËS NE AFAT PREJ 13 MUAJSH
Fillimi i Ekzekutimi	9.1	KJO KONTRATË DO TE FILLOJË TE EKZEKUTOHET NGA DATA E NENSHKRIMIT DHE PERFUNDON ME PERMBUSHJEN E PLOTE TE SAJ NE NJE AFAT PREJ 12 MUAJSH.
Cilësia e furnizimeve	16.2	CILESIA DHE KUALITETI-DUHET TE JENE NE PERPUTHJE TE PLOTE ME SPECIFIKIMET E DETYRUESHME TEKNIKE – ANEKS I KONTRATËS- pershkrimi teknik
Inspektimi dhe testimi	17.2	INSPEKTIMI DHE TESTMI I MATERIALEVE DO TE BEHET PERMES ORGANEVE KOMUNALE – MODALITETET DO TI VENDOS NJËSIA E IMPLEMENTIMIT TE KONTRATËS. NË ÇDO RAST AUTORITETI KONTRAKTUE REZERVON TE DREJTËN QE MALRAT TE CILAT NUK I PLOTËSOJNE KARAKTERISTIKAT E PERSHKRUARA TI REKLAMOJË DHE TE NJEJTAT MOS TI PRANOJË.
Dorëzimi	19.3	DORËZIMI I MATERIALEVE BEHET, SIPAS SPECIFIKACIONIT TE DREJTORATIT PERKATES BAZUAR NE KIRKESAT E NJESIVE KERKUESE ME SE LARTËSI DITE PASKERKESËS
Obligimet e garancionit	22.1	N/A
Shërbimet pas shitjes	23.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	ÇDO MOSMAREVESHTJE EVENTUALE TE CILAT MUND TË LINDIN, DO TE ZGJIDHEN NË MËNYRË MIQËSORE – NGA ORGANET KOMUNALE – DREJTORATI PERKATES
Zgjidhja e	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet

mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore		ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Në GJYKATEN THEMELORE – DEPARTAMENTI PER ÇASHTJE EKONOMIKE - PRISHTINË ose
---	--	--

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA: FURNIZIMI I INSTITUCIONEVE
KOMUNALE ME LENDE DJEGESE-DRU AHU**

	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma(€)
Blerja, furnizimi, liferimi dhe sharritja e lendes djegese - dru ahu	m/h	2500	42.00 €	105,000.00 €
TOTALI ME TVSH:				105,000.00 €

Drutë duhet të jene te cileses se mire, te njoma, shendosha dhe diametri minimal i drurit te jete 20cm.
imi behet nga kompania fituese e tenderi, e ne vendin ku shkarkohen drute, duhet te palosen ne metra hapsinore, matja behet ne prezencen e personit(zyrtarit) pergjegjs te DKA, institucionit shkollor dhe nje tjeter, te cilet e bejn edhe pranimin e mallit.
ja ne m/h ne oborret e instit.shkollore dhe sharritja-gjatsia, sipas kerkesave te institucionit shkollor duhet te kryhet nga kompania fituese e tenderit - ate ne afat te menjehershem pas bartjes se druve.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]